



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. 584 / Prot.  
16

Tiranë, më 19.04.2021

VENDIM

Nr. 57, datë 19.04.2021

PËR  
MIRATIMIN E RREGULLORES SË TRANSFERIMIT TË STUDIMEVE NË  
UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS

Në zbatim Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL e RSH”, neni 40, të Statutit të UST-së, neni 25, në Rregulloren e UST-ë neni 11, Senati Akademik në mbledhjen e datës 19.04.2021

VENDOSI:

1. Miratimin e Rregullores së Transferimit të Studimeve në Universitetin e Sporteve të Tiranës.
2. Një kopje e këtij Vendimi, i përcillet Njësive Kryesore të UST-së dhe Degës së Informacionit Studentor dhe Regjistrimeve.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT

PROF.DR. AGRON KASA





---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS

**KREU I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

Kjo rregullore është hartuar mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, të akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji, në Statutin e Universitetit të Sporteve të Tiranës, në Rregulloren e Përgjithshme të Universitetit të Sporteve të Tiranës, në përputhje me kërkesat e Procesit të Bolonjës.

**Neni 2**

Kjo rregullore përcakton kushtet, kriteret dhe procedurat e transferimit të studentëve nga Institucione të Arsimit të Lartë (më poshtë IAL) vendase ose të huaja, publike ose jopublike në Universiteti i Sporteve të Tiranës (më poshtë UST), të transferimit të studimeve brenda UST, të transferimit nga programe studimi të fushave të njëjta ose të përafërta, të transferimit në vitet e ndërmjetme të programeve të studimit.

**Neni 3**

1. Gëzojnë të drejtën për transferim të studimeve në UST të gjithë studentët e regjistruar në IAL vendase ose të huaja, të licencuara dhe të akredituara si institucion dhe të akredituara për programin e studimit që ka ndjekur studenti.
2. Periudhat e studimit dhe detyrimet e programeve të studimit, të shlyera në institucione të tjera të vendit ose të huaja, njihen dhe njësohen, nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar arsimimin, në një program studimi të njëjtë ose të ngjashëm.
3. Vendimi për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve të fituara nga një student që transferohet, me qëllim vazhdimin e studimeve në UST, i takon komisionit përkatës, të ngritur nga njësia bazë e UST.



## **KREU II KËRKESA DHE DOKUMENTE PËR TRANSFERIM NË UST**

### **Neni 4 Kërkesa**

1. Studenti që dëshiron të transferohet nga një IAL në UST, duhet të paraqesë një kërkesë me shkrim pranë Sekretarisë Mësimore të UST-se, sipas formularit standard të miratuar.
2. Kërkesat për transferim jashtë afateve ligjore nuk trajtohen dhe si të tilla refuzohen.

### **Neni 5 Dokumentet**

1. Studenti që dëshiron të transferohet nga një IAL në UST në momentin e aplikimit duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
  - a. Kërkesë me shkrim sipas formularit standard të miratuar nga UST.
  - b. Dokument që vërteton statusin e studentit në institucionin nga vjen.
  - c. Vërtetim nga IAL-ja të listës së notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer në programin e studimit që ka ndjekur, i cili do të shërbejë për ekuivalentimin e krediteve dhe të notave të lëndëve të programit të studimit të ndjekur.
  - d. Paketë e programit të studimit të ndjekur në IAL-në nga kërkon të transferohet, që përmban planin mësimor të programit të studimit që ka ndjekur, programet mësimore të lëndëve përkatëse, domosdoshmërisht programet e lëndëve mësimore me kreditet e fituara dhe vlerësimet pozitive.
  - e. Kopje origjinale dhe e noterizuar e Diplomës dhe e Certifikatës së Maturës Shtetërore ose e dëftesës së pjekurisë së shkollës së mesme, kjo e fundit për kandidatin që ka përfunduar shkollën e mesme në Republikën e Shqipërisë përpara vitit 2011. Në mungesë të diplomës së Maturës Shtetërore apo të dëftesës së pjekurisë së shkollës së mesme, kandidati duhet të paraqesë dublikatë të këtyre dokumenteve të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme të vërtetuar në Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar/Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar (DRAP/ZVAP) përkatëse ose listën e notave të shkollës së mesme të lëshuar nga Arkivi i Shtetit.
  - f. Fotokopje e dokumentit të identifikimit.
  - g. Dy fotografi personale.
  - h. Kopje e mandat pagesës.
2. Në momentin e regjistrimit përfundimtar (pas shpalljes fitues), kandidati paraqet dhe dokumentin origjinal të çregjistrimit nga IAL-ja nga ku transferohet, i cili duhet të përmbajë:
  - a. Emrin, atësinë, mbiemrin;
  - b. Datëlindjen;
  - c. Vendlindjen;



- d. Shtetësinë;
- e. Numri i matrikullimit që ka patur në IAL-në përcjellëse;
- f. Emrin e shkollës së mesme/ IAL-së ku ka ndjekur studimet para transferimit;
- g. ID-në e Maturës Shtetërore/Nr. Regj. të veçantë për kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme para viti 2006;
- h. Numrin personal të identitetit;
- i. Datën e regjistrimit në programin e studimit të ofruar nga IAL-ja;
- j. Emërtimin e programit të studimit dhe fakultetit përkatës;
- k. Ciklin dhe formën e studimit;
- l. Datën e ndërprerjes së studimeve.
- m. Studentët që transferojnë studimet nga një institucion i huaj i arsimit të lartë duhet të dorëzojnë të gjitha dokumentet e aplikimit dhe të regjistrimit të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të njësuara me origjinalin.

### **KREU III**

#### **PROCEDURA PËR NJOHJEN DHE TRANSFERIMIN E KREDITEVE**

##### **Neni 6**

##### **Kushtet për transferim**

1. Procedura e transferimit kryhet sipas legjislacionit në fuqi.
2. Transferimi i studimeve bëhet sipas kuotave dhe kriterëve të përgjithshme dhe specifike të pranimit, të miratuara për çdo program studimi nga Senati Akademik i UST dhe të publikuara paraprakisht para fillimit të vitit akademik pasardhës.
3. Nuk mund të kryhet transferim gjatë semestrit të parë dhe të gjashtë për ciklin e parë.

##### **Neni 7**

##### **Procedura e vlerësimit të dokumentacionit dhe e vendimmarrjes**

1. Njësia e Sigurimit të Cilësisë e UST ka përgjegjësinë të verifikojë legjitimitetin e IAL-së nga vjen studenti, nivelin e programit të studimit që ka ndjekur studenti, origjinalitetin e dokumenteve të paraqitura.
2. Njohja dhe transferimi i krediteve bëhet nga një komision ad-hoc i ngritur nga drejtuesi i njësisë bazë që mbulon programin përkatës të studimit dhe i miratuar nga dekan i njësisë kryesore.
3. Dokumentacioni i aplikimit për transferim i dorëzuar në Sekretarinë mësimore i kalohet me procesverbal drejtuesit të njësisë bazë, i cili ia përcjell komisionit ad-hoc të njësisë bazë për shqyrtim.
4. Komisioni *ad hoc* pasi e shqyrton kërkesën dhe dokumentacionin përkatës dhe bën vlerësimin për çdo kriter vlerësimi, merr vendimin të cilin ia përcjell drejtuesit të njësisë bazë, i cili ia përcjell dekanit të njësisë kryesore për miratim dhe më pas dekan i njësisë kryesore shkresën përkatëse të miratuar Sekretarisë mësimore të UST për zbatim.
5. Lista e kandidatëve të pranuar për transferim të studimeve bëhet publike nga njësia kryesore.





6. Të gjitha notat dhe kreditet e pranuar sipas vendimit të miratuar të komisionit *ad hoc* regjistrohen nga Sekretaria mësimore në regjistrin e arritjeve në variantin e shkruar dhe elektronik.

## Neni 8 Kritere për vlerësimin

1. Komisioni *ad hoc* i njësisë bazë kryen vlerësimin e dokumentacionit të transferimit bazuar në këto kritere:
  - a. *Kriteri ligjor*. Vlerëson procedurën e ndjekur për aplikim në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe këtë rregullore duke përcaktuar nëse kandidati është i përshtatshëm për t'iu nënhtuar procedurës së transferimit.
  - b. *Kriteri i përputhjes së dokumentacionit pedagogjik*. Vlerëson përputhjen e planit mësimor dhe të programeve mësimore lëndore të programit të studimit të IAL-së nga vjen studenti me planin mësimor dhe programet mësimore të lëndëve të programit të studimit që ofron UST. UST njih dokumentacionin pedagogjik të programit të studimit të IAL-së nga vjen kandidati, kur ai përputhet me objektivat e programit përkatës të studimit në UST.
  - c. *Kriteri i vlefshmërisë së krediteve të fituara, notave*.
    - i) Transferimi kryehet nëse kandidati përmbush kriterin e notës mesatare, e përcaktuar sipas akteve nënligjore në fuqi.
- Sasia e pranuar e krediteve për transferim bëhet bazuar në aktet nënligjore në fuqi.
  - ii) Kreditet e fituara njihen plotësisht ose të pjesërisht. Kur gjykohet e nevojshme, përcaktohen detyrimet plotësuese që kandidati duhet të shlyejë.
  - iii) Studenti që ndjek studimet në ciklin e parë, mund të transferojë studimet në UST, nëse ka fituar deri në 30 kredite në vitin e parë, 30-60 kredite në vitin e dytë dhe mbi 60 kredite në vitin e tretë.
  - iv) Numri i krediteve që njihen për t'u transferuar në programet e studimit të ciklit të dytë është jo më shumë se 40 kredite.
  - v) Kreditet e lëndëve që studentit i janë njësuar do të llogariten në shumën totale të krediteve të marra në atë cikël studimi.
  - vi) Për njohjen e krediteve të një lënde, si bazë shërben ngarkesa mësimore në auditor në lëndë sipas planeve mësimore të UST-se dhe atyre të IAL-së nga vjen kandidati, ndërsa për transferimin e krediteve merret për bazë numri i krediteve të lëndës, numri i krediteve që i takojnë modulit që e përmban atë lëndë dhe numri i krediteve që u janë rezervuar lëndëve me zgjedhje.
  - vii) Kur lënda ka emërtim të njëjtë ose përmbajtje të njëjtë në të dyja planet mësimore, njohja dhe transferimi i krediteve bëhet vetëm në bazë të ngarkesës mësimore në auditor, që do të thotë se sasia e krediteve që njihen dhe transferohen përlllogariten në përpjestim të drejtë me ngarkesën mësimore në auditor.
  - viii) Kur ngarkesa mësimore në auditor e një lënde, sipas planit mësimor të UST-se rezulton e njëjtë me atë të planit mësimor të IAL-së, njohja dhe transferimi i krediteve të asaj lënde bëhet i plotë.
  - ix) Kur ngarkesa mësimore në auditor e një lënde, sipas kurrikulave të UST-se rezulton më e madhe se në planin mësimor të IAL-së (edhe pas marrjes parasysh të orëve për



një kredit), kandidati do t'i njihen dhe transferohen vetëm një pjesë e krediteve që i takojnë asaj lënde në UST. Kreditet e *mbetura* do të mund të fitohen ose nëpërmjet ndjekjes dhe shlyerjes së një lënde me zgjedhje që e përmban moduli përkatës ose nëpërmjet një punimi individual, tematika e të cilit duhet të lidhet me përmbajtjen e modulit dhe përaktohet nga komisioni ad-hoc.

- x) Kur ngarkesa mësimore në auditor e një lënde, sipas planit mësimor të UST-se, rezulton më e vogël se në planin mësimor të IAL-së, kandidati do t'i njihen aq kredite sa përmban plani mësimor përkatës në UST.
2. Njohja e notave bëhet sipas sistemit të notave (4-10) dhe konvertimi i notave të fituara në IAL të huaja bëhet në përputhje me tabelën e ekuivalentimit të sistemeve të vlerësimit të miratuar nga UST. Kur gjykohet e nevojshme, përcaktohen lëndët për të cilat kandidati duhet të riprovohet pranë UST si dhe afatet kohore përkatëse.
3. Miratimi i programit të studimit, viti i studimit dhe semestri bëhet sipas propozimit të kandidatis nëse gjendet i përputhshëm me kriteret ose përcaktohet programi i studimit, viti i studimit dhe semestri i përshtatshëm në bazë të vlerësimit të dokumentacionit dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara.
4. Nëse kandidati, krahas transferimit, dëshiron të ndërrojë edhe degën apo profilin ose kur bëhet fjalë për transferime nga IAL të huaja, komisioni *ad hoc* përkatës njihet me përmbajtjen e lëndëve potencialisht të transferueshme, në mënyrë që të bëhet i mundur transferimi maksimal i mundshëm i krediteve të fituara.

### **Neni 9 Diplomimi**

1. Studentëve që janë transferuar në UST u jepet diplomë Bachelor me kusht që të kenë kryer të paktën dy semestra në UST.
2. Studentëve që janë transferuar në UST u jepet diplomë Master me kusht që të kenë kryer të paktën një semestër në UST.

### **Neni 10 Ankimimi**

1. Në rast se kandidati nuk bie dakord me vendimmarrjen e komisionit *ad hoc*, ai mund ta ankimojë vendimin në Rektorat brenda tri ditëve kalendarike nga shpallja e rezultateve.
2. Në këtë rast Rektori ngre një Komision rivlerësimi me tre anëtarë nga personeli akademik, të cilët nuk kanë qenë anëtarë të komisionit *ad hoc*.
3. Komisioni i rivlerësimit rishikon procedurat e ndjekura, dokumentacionin përkatës dhe analizon vendimin e marrë. Në rast se e shikon të nevojshme, komisioni i rivlerësimit thërret për sqarime komisionin përkatës të transferimit ose anëtarë të veçantë të tij. Vendimi i Komisionit të rivlerësimit është i formës së prerë.
4. UST shprehet me vendim të argumentuar lidhur me ankimimin brenda dy ditëve pune nga data e paraqitjes së ankesës.



### **Neni 11**

#### **Regjistrimi i vendimmarrjes**

1. I gjithë dokumentacioni i transferimit ruhet në dosje të veçanta për transferimet dhe arkivohet.
2. Për të gjitha transferimet mbahet një regjistër i veçantë ku regjistrohen vendimet e marra.
3. Regjistri i transferimeve administrohet nga Sekretaria mësimore e UST.
4. Sekretaria mësimore e UST regjistron studentët e transferuar në regjistrin themeltar të studentëve dhe në regjistrin e arritjeve akademike.

### **KREU IV**

#### **DISPOZITA TË FUNDIT**

### **Neni 12**

1. Për rastet për të cilat nuk mund të merret një vendim i qartë sipas neneve të kësaj rregulloreje, dokumentacioni i transferimit shqyrtohet, vlerësohet dhe miratohet në një mbledhje të veçantë të Rektoratit të UST në bazë të një relacioni të paraqitur nga dekani i njësisë kryesore ku kërkohet transferimi.
2. Në të gjitha rastet vendimi për transferim i kalohet për zbatim Sekretarisë mësimore dhe për dijeni kandidatit.

### **KREU V**

#### **HYRJA NË FUQI**

### **Neni 14**

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit në Senatin akademik të UST.

### **Neni 15**

Kjo rregullore është objekt ndryshimi sipas legjislacionit në fuqi.

### **Neni 16**

Zbatimi i kësaj rregulloreje mbikëqyret nga Rektori i UST.